



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane ,nenit 11 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019 si dhe nenit 20 par. 1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 30. 10. 2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE DHE
KRYETARËVE TË KËSHILLAVE LOKALE

Neni 1

Me këtë Vendim përcaktohet që Organizimi i zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale në territorin e Komunës së Lipjanit të fillojë në fillim të muajit janar të vitit 2020 dhe të përfundojnë me datë 31 mars të vitit 2020.

Neni 2

Komisioni i Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e këshillave lokale do ti kryej të gjitha detyrat, përkitazi me organizimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave të lokale në pajtim me dispozitat e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019

Neni 3

Për mënyrën e sigurimit të mjeteve të nevojshme financiare për organizimin e zgjedhjeve të cekura do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Nr.15- 013 - 70943
Lipjan, më 31. 10. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

